



## KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

01/02/2022

Nr.No.Bi.

01/145

Kryetari i Komunës

Nr. 01/\_\_\_

Datë; 24/01/2022

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 24.01.2022 mori këtë;

## V E N D I M

## FORMOHET SHTABI PËR MENAGJIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID 19 DHE VARIANTEVE TË KËTIJ GRUPI TË VIRUSEVE, PËR KOMUNËN E MALISHEVËS

I. Formohet, shtabi për menagjimin e situatës me rastin e shtimit të rasteve të infeksioneve me Covid 19 dhe varianteve tjera të këtij grupi të viruseve, në territorin e Komunës së Malishevës.

I I. Bazuar në nenin 1 të këtij vendimi, shtabi formohet me anëtarët e cekur si më poshtë;

1. Drejtori i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, z.Hajdin Berisha.
2. Drejtori i drejtorisë për administratë, z.Fatmir Ademi,
3. Drejtori i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim,....
4. Drejtori i drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet, z.Blerim Thaçi,
5. Drejtori i drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësor-juridik, z.Bashkim Krasniqi,
6. Drejtori i drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, z.Murat Hoxha,
7. Drejtore e drejtorisë për arsim dhe edukim, zj. Arbreshë Krasniqi,
8. Drejtore e drejtorisë për inspektoriat, zj.Besartë Kryeziu Rama,
9. Drejtori i drejtorisë për shërbime publike, z.Rifat Mazreku,
10. Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, rini dhe sport, z.Fitim Shala,
11. Drejtori i Drejtorisë për urbanizëm, z.Avdi Morina,
12. Përfaqësuesi i zyrës për informim publik, z.Artan Paçarizi,
13. Përfaqësuesi i Stacionit të Policisë në Malishevë,
14. Drejtori i QKMF-së, " Shpëtim Robaj " në Malishevë,Dr.Afrim Krasniqi.

I I I. **Autorizohet**, drejtori i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, z.Hajdin Berisha, që të udhëheq këtë shtab, konform dispozitave ligjore, apo udhëzimeve të institucioneve kompetente të nivelit qendrorë, Ministrisë së Shëndetësisë apo IKSHP-së, si dhe institucioneve tjera të autorizuara me ligj.

I V. Për ekzekutimin e këtij vendimi, do të kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorëve të drejtorive të lartcekura.

V. Ky vendim shfuqizon vendimin nr,01/104, dt.25.01.2022, ndërsa i njëjti vendim me datë 31.01.2022.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Shtabit,
2. Arkivit të komunës.





Kryetari i Komunës  
Nr. 01/155  
Datë; 31/01/2022

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 ( shkronja f dhe g ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm,

*Kryetari i Komunës me datë 31 .01. 2022 mori këtë;*

**AKTVENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

I. Formohet komisioni për pranim teknik të projektit “ Ndërtimi i trafostacionit për kyçe të objekteve publike për dy qendrat e banimit social dhe për dy çerdhet publike ne Malishevë” kontrata nr.04, prot.03/04, d.28.01.2021, sipas prokurimit identifikues 6250021.107.521 dhe aneks kontratës nr.03/103, dt.29.12.2021.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre ( 3 ) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Mehdi Krasniqi -Kryetar i komisionit,
- 2. Januz Krasniqi- anëtar,
- 3. Jakup Shurdhaj- anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha procedurave si dhe realizimin e projekti të lartcekur, konform kontratës publike të lidhur në mes operatorit ekonomik dhe shërbimit të prokurimit, në emër të KK- Malishevës.

I V. Të gjitha dokumentet si dhe akti i pranimit-dorëzimit teknik duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

- 1. Komisionit
- 2. Arkivit të komunës





Kryetari i Komunës

Nr. 01/154

Datë: 01/02/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 ( shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal ( Ligji nr.03/L-049 ), Ligjit të prokurimit publik dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës, paramasën dhe parallogarinë e drejtorisë për urbanizëm,

*Kryetari i Komunës me datë 01.02. 2022 mori këtë;*

### AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 300,000.00 €.

I I. Mjetet ndahen në emër të inicimit të procedurës së prokurimit publik, për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, për hartimin e projekteve për nevoja publike, të komunës së Malishevës.

I I I. Vlera e parashikuar është përcaktuar sipas paramasës dhe parallogarisë së përgatitur nga drejtoria për urbanizëm, dhe përfshinë afatin tri vjeçarë, 2022/2023 dhe 2024.

I V. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për urbanizëm, përmes shërbimit të prokurimit publik.

V. Ky aktvendim hynë në fuqi, më datë 01.02.2022.

Kryetari i Komunës

Ekrem Kasprari



Aktvendimi ju dorëzohet:

- 1.Drejtoirisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
- 2.Drejtoirisë për urbanizëm,
- 3.Shërbimit të prokurimit publik,
- 4.Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës  
Nr. 01/152  
Datë; 01/02/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 ( shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal ( Ligji nr.03/L-049 ), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

*Kryetari i Komunës me datë 01.02. 2022 mori këtë;*

### AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 350.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije të shkaktuara nga organet e komunës së Malishevës, me rastin e pritjeve zyrtare.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Aktvendimi j u dorëzohet :

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës

Nr. 01/153

Datë; 01/02/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 ( shkronja b dhe d ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal ( Ligji nr.03/L-049 ), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

*Kryetari i Komunës me datë 01.02. 2022 mori këtë;*

### A K T V E N D I M

I. Lejohet peti kesh-i, në shumat e cekura si më poshtë:

- Për nevojat e zyrës së kryetarit të komunës, lejohet shuma e mjeteve financiare prej.....1000 €.
- Për nevojat e zyrës së nënkryetarit të komunës, lejohet shuma e mjeteve financiare prej.....200 €.
- Për nevojat e zyrës së kryesuesit të komunës, lejohet shuma e mjeteve financiare prej.....100 €.
- Për nevojat e administratës komunale,lejohet shuma e mjeteve financiare prej.....1,000 €.
- Për nevojat e drejtorisë për arsim dhe edukim si dhe organeve vartëse lejohet shuma prej.....1,000 €.
- Për nevojat e drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe organeve vartëse lejohet shuma financiare prej..... 1,000 €.

-Për nevojat e drejtorëve të drejtorive lejohet shuma prej 50 €, në muaj për pritjet zyrtare.

I I. Peti kesh-i, duhet të përdoret konform rregullave ligjore për pagesat me vlerë të vogël, në emër të kryerjes së shërbimeve në kuadër të ligjit për qëllime publike.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi, autorizohet drejtoria për ekonomi, buxhet dhe financa.

I V. Ky aktvendim shfuqizon çdo akt tjetër të institucioneve të komunës së Malishevës, që ka rregulluar këtë formë të pagesës për kryerjen e shërbimeve publike të KK- Malishevës.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës  
Ekrem Kastrati



Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Ekonomi,Financa dhe Buxhet,
2. Arkivit të komunës.



Kryetari i Komunës  
Nr. 01/156  
Datë; 01/02/2022

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 ( shkronja f dhe g ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për shërbime publike,

*Kryetari i Komunës me datë 01 .02. 2022 mori këtë;*

**AKTVENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

I. Formohet komisioni për rivlerësimin e gjendjes ekonomike dhe kontrollin dhe verifikimin e shfrytëzuesve të banesave në objektin e banesave me karakter social, me numër 01.

I I. Komisioni formohet sipas kërkesës së drejtorisë për shërbime publike, nr.09/07-MB, 31.01.2022, në përbërje prej tre ( 3 ) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Elbasane Shala-Kryetare e komisionit,
- 2. Ramiz Hoxha- anëtar,
- 3. Fadil Shala- anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin dhe rivlerësimin e kushteve të parapara sipas ligjit dhe kontratave me rastin e shfrytëzimit të banesave publike, në objektin e banimit me karakter social, nr.1.

I V. Ky aktvendim anulon çdo akt tjetër të këtij organi në lidhje me këtë çështje, ndërsa i njëjti hyn në fuqi me datë, 01.02.2022.

Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për shërbime publike,
2. Komisionit,
3. Arkivit të komunës.





Kryetari i Komunës

Nr. 01/162

Datë: 02.02.2022

Mbështetur në nenin 13 neni dhe neni 58 ( shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) , neni 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 42 par. 2 të Rregullores (QRK), Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe sipas kërkesës së Udhëheqësit të Personelit Nr. 01/161 i datës 02.02.2022 , Kryetari i Komunës merrë këtë:

### VENDIM

**I. APROVOHET** kërkesa e zyrës se personelit dhe zhvillimi i procedurave të brendshme për **Lëvizje Paralele**, për pozitën **Zyrtar për Ndërtimtari**, në **Drejtorinë për Urbanizëm**.

**II.** Zhvillimin e procedurës së lartcekur në pikën I të këtij vendimi do ta zhvilloj Zyra e Personelit në Komunën e Malishevës, konform dispozitave përkatëse ligjore.

**III.** Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

I dërgohet:

-Arkivit

-NJMBNJ-së

Kryetari i Komunës  
Ekrem Kastrati





Kryetari i Komunës

Nr. 01/45

Datë; 18/01/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 ( shkronja b,e dhe f ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Viti III/nr.28/04 Qershor 2008, dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës, bazuar edhe në Udhëzimin Administrativ nr.01/2018, për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna,

*Kryetari i Komunës me datë 18.01. 2022 mori këtë;*

### V E N D I M

I. z.Rexhep Mazreku, i lindur me datë, 18.12.1960, me numër personal të letërnjoftimit të RKS-së, nr.1016106557 nga Malisheva, KK- Malishevës, **emërohet;**

*- Zyrtar në zyrën e kryetarit -.*

I I. Emërimi bëhet në pajtim me, Udhëzimit Administrativ nr.01/2018, për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.

I I I. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, duke përfshirë edhe të drejtën në pagë, duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në Republikën e Kosovës.

I V. Për ekzekutimin e këtij vendimi, autorizohet shërbimi i personelit, në Komunën e Malishevës.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të vlejë deri në një vendim tjetër të këtij organi.

Vendimi ju dorëzohet :

1. Palës,
2. Shërbimit të Personelit,
3. Arkivit të komunës.







REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNË E MALISHEVË  
THE MUNICIPAL ASSEMBLY - MALISHEVË - SKUPŠTINA OPŠTINE MALISHEVO



**Komisioni Disiplinor**

**Nr.01/**

**Datë:**

PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

08/02/2022

01/194.

Komisioni Disiplinor në përbërje me Fadil Shala - kryetar, Valentina Krasniqi-Zogaj dhe Hysni Gjyliqi - anëtarë, në bazë Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 0/6L-114 neni 46 paragrafi 1,2 nënparagrafi 2.1, paragrafi 3 nënparagrafi 3.5, neni 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe neni 48 . Rregullorja me nr.11/2022 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik neni 7 paragrafi 2 dhe 6 , neni 8 pas shqyrtimit të provave dhe fakteve në seancat disiplinore në lidhje me shkeljen e supozuar nga zyrtari z.Ismajl Zogaj i sistemuar në punë dhe detyra të punës: zyrtar i pylltarisë në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me datën 04.02.2022 me votim unanim merrë këtë:

## V E N D I M

I. z.Ismajl Zogaj i lindur 08.11.1970 në fshatin Lladroc, Komuna Malishevë i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i Pylltarisë në DBPZHR, i shqiptohet masa disiplinore: **LARGIM NGA SHËRBIMI CIVIL.**

**II. LARGIMI NGA SHËRBIMI CIVIL nga data 04.02.2022** ku i pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

**II.** Për zbatimin e këtij vendimi, autorizohet shërbimi i personelit, në Komunën e Malishevës.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e komisionit disiplinor.

## Arsyetim

Pas pranimit të raportit nga Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z.Murat Hoxha, komisioni disiplinor ka mbajtur seancë me datën 02.02.2022 dhe është vlersuar që të ftohet fizikisht zyrtari z.Ismajl Zogaj që të jetë prezent dhe të njoftohet mbi shkeljen e supozuar disiplinore dhe të ofrohen provat me shkrim .Gjithashtu është ftuar edhe drejtori i DBPZHR z.Murat Hoxha te prezantoj ne seancën e 04.02.2022.

Komisioni disiplinor fillon shqyrtimin e shkeljes se supozuar dhe shqyrtimin e provave dhe fakteve te raportuara. Kërkojmë të deklaroj mbi shkeljen e supozuar dhe provat e paraqitura nga z.Murat Hoxha, menaxher drejtues i te punësuarit z.Ismajl Zogaj dhe jep këtë deklaratë:

1. Nga cila datë deri në cilën datë mungon i punësuarit?

z.Murat Hoxha përgjigjet: Nga data 12.01.2022 deri me sot datë: 04.02.2022 nuk është paraqitur në punë. Kemi pasur tentime të komunikimit përmes telefonit, ndërsa e-mailin e tij nuk na ka dhënë, përpjekjet tona kanë qenë që të njoftojmë se po bënë shkelje për shkak mos ardhjes në

dhënë, përpjekjet tona kanë qenë që të njoftojmë se po bënë shkelje për shkak mos ardhjes në punë dhe moskryerjes së detyrave në punë, por edhe pas kësaj nuk kemi gjetur vullnetin e tij për të ardhur në punë. Si menaxher drejtues me datën 26.01.2022 kam shqiptuar vërejtje me shkrim sipas ligjeve në fuqi, vërejtje është protokolluar me 27.01.2022, me numër 08/08, dhe këtë ja kam përcjellur përmes zyrës së pritjes z.Ismajl Zogaj. Edhe në kohën e shqiptimit të vërejtjes punëtori ka munguar dhe si provë është dërgimi i vërejtje përmes zyrës së pritjes, gjithashtu gjatë kësaj periudhe të mungesës së tij në si drejtori kemi pasur pengesa në realizimin e detyrave të planit të punës si drejtori. Pas këtyre mungesave të vazhdueshme kam raportuar shkeljet nga z.Ismajl Zogaj për shqyrtim pranë komisionit disiplinorë tek njësia e Personelit, provë raporti i datës 27.01.2022. Unë Murat Hoxha deklaroj se që nga marrja e ftesës me datën 02.02.2022 nr.01/165 deri me sot zyrtari në fjalë rapë vazhdon të mos jetë në punë.

Komisioni Disiplinor shqyrton shkeljen dhe provat:

z.Ismajl Zogaj ka aktemrim nga Komuna e Malishevës me numër 01/1192 të datës 17.12.2021, në pozitën zyrtar i Pylltarisë dhe të drejtat dhe detyrimet e tij sipas këtij aktemrimit fillojnë nga data 03.01.2022. z.Ismajl Zogaj nuk ju ka përmbajtur detyrimeve sipas marrëdhënies së punës dhe sipas raportit të drejtorit të bujqësisë i datës 27.01.2022 nr. 08/05 i lartë përmenduri nuk është paraqitur në vendin e punës dhe nuk i ka kryer detyrat e punës nga data 12.01.2022 dhe vazhdon deri më sot, sipas deklaratës së dhënë para komisionit nga menaxheri drejtues.

Zyrtari në fjalë sipas raportit dhe fakteve të prezantuar dhe deklaruara nga menaxheri drejtues konfirmohet se ka bërë shkelje disiplinore të rënda sipas ligjit të zyrtarëve publik nr. 0/6L-114, neni 46 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, paragrafi 3 dhe nënparagrafi 3.5, si dhe Rregullores nr.11/2022 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, neni 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2.

Shkelja eksiton dhe është e argumentuar konform legjislacionit të lartcekur - Shkelje e rëndë:

**1). Braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për 5 ditë punë apo më shumë.**

z.Ismajl Zogaj me datën 12.01.2022 nr. prot. 01/43, ka bërë kërkesë për pushim pa pagesë drejtuar Kryetari Komunës dhe Zyrës së Personelit, pas kërkesës së bërë është zhvilluar shqyrtimi i kërkesës dhe organi punëdhënës e ka refuzuar kërkesën e tij, sipas aktvendimit nr.prot. 01/92 i datës: 21.01.2022 nga Kryetari i Komunës. Kërkesa është bërë nga zyrtari në fjalë dhe nga data 12.01.2022, nuk ka vijuar punën dhe nuk është paraqitur pranë DBPZHR.

Kërkesa nuk është bërë dhe nuk është arsyetuar sipas legjislacionit në fuqi. Sipas rregullores nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e zyrtarëve publikë, të nenit 14 paragrafi 1, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.2, 2.3, të cilat arsye nuk i ka paraqitur dhe argumentuar. Gjithashtu sipas nenit 3 të kësaj rregullore paraqitja e kërkesës mund të bëhet nga i punësuari, por nuk i jep të drejt që mos të vije në punë deri sa ta marrë përgjigjen nga organi kompetent. Në kërkesën e tij për pushim pa pagesë z. Zogaj në arsyetim i cek faktet të cilat nuk parashihen sipas legjislacionit në fuqi, gjithashtu nuk ka prezantuar asnjë provë materiale në lidhje me kushtet që janë të parapara me ligj në lidhje me kërkesën për pushim pa pagesë.

Në kuadër të mos vijueshmërisë në punë menaxheri drejtues sipas legjislacionit në fuqi i ka shqiptuar vërejtje me shkrim me numër të prot.08/08 i datës 27.01.2022, provë materiale vërejtja.

Komisioni disiplinor e ka njoftuar për shkeljen e prezantuar dhe e ka ftuar në mënyrë të rregullt z.Zogaj dhe menaxherin drejtues z.Murat Hoxha, në lidhje me prezantimin e fakteve dhe provave

si dhe deklaratimet direktet në seancë për të cilat menaxheri drejtues ka qene prezent, ndërsa z.Zogaj ka munguar, provë për njoftim me shkrim është shkresa nr.prot. 01/165 e datës 02.02.2022.

Komisioni disiplinor duke i shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet si dhe duke parë mos gatishmërinë dhe mos vullnetin e zyrtarit z.Zogaj që të vije në punë dhe duke mos arsyetuar mungesën e tij , pas kërkesës sonë që ta arsyetoj mosardhjen në punë duke i paraqitur faktet me shkrim të cilën nuk e ka bërë . Shkaku dhe fakt i mosardhjes ne punë pandërprere nga data 12.01.2022 te cilën nuk është duke e arsyetuar z.Ismajl Zogaj, është dyshimi i bazuar sepse ka marrëdhënie të punës tek mikrofinanca "FINCA" në Malishevë. Në bazë të fakteve të lartcekura komisioni nuk ka pasur mundësi të shqiptoj masë tjetër disiplinore të paraparë me ligjin në fuqi. Prandaj komisioni vlerëson se shkelja ekziston dhe në proporcion me të shqiptohet masa disiplinore dhe konform Ligjit të Zyrtarëve Publik 06/L-114, neni 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, : a) Largim nga Shërbimi Civil nga data 04.02.2022.

Komisioni disiplinor vendos që të nxjerrët vendimi dhe të njoftohen palët:

1. Ismajl Zogaj - Zyrtar i Pylltarisë
2. Zyra e Personelit
3. Arkiva

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj Ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në afat prej 30 ditës nga marrja e këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

1. Zyrës së personelit
2. Palës
3. Dosjes së punetorit
4. Arkivit të komunës

**Komisioni:**

Fadil Shala - kryetar

Valentinë Krasniqi-Zogaj - anëtare

Hysni Gjyliqi - anëtar

